



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 6.2.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Zef Morina, Berat Luzha, Hestet Cakolli, Elhëme Hetemi, Naim Maloku, Ali Lajçi dhe Selvie Halimi.

Munguan : Dragisha Miriç, Zulf Merxha .

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MMPH: Tirana Baftiu, Lirije Berisha dhe nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku

Mbledhjen e kryesoi : **Selvie Halimi**, anëtare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për Tokën Ndërtimore,
3. Shqyrtimi i projektligjit për administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi.

**Kryesuesja Selvie Halimi** dhe anëtarët tjerë të komisionit në fillim përshëndetën dhe i dëshiruan mirëseardhje anëtarit të ri të komisionit **Naim Malokut** me funksion Nënkryetar i Komisionit, pastaj konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesja** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për Tokën Ndërtimore**

**Selvie Halimi** kërkoi nga zyrtarët e MMPH mendimin rreth këtij projektligji, ngase nga mendimet e deritashme në këtë komision dominon bindja për kthimin e këtij projekti në ripunim. **Bajram Latifi** nga kabineti i ministrit të MMPH tha se janë të njoftuar me diskutimet e deritashme në këtë komision dhe shprehu pajtimin në emër të MMPH për kthimin e projektligjit në Qeveri përmes Kuvendit.

**Zef Morina** konsideroi se do të ishte e palogjikshme të kthehet tani ky projekt ngase ka kaluar një vit nga miratimi në parim, megjithëse kërkesa është e logjikshme. Në fakt ai mendon se ky projekt mund të kaloi por pa pjesën e privatizimit (pronësimit).

Anëtarët tjerë (**Ali Lajçi, Naim Maloku, Elheme Hetemi, Haset Cakolli**) konsideruan se mungesa e ligjit për pronën do të vështirëson procedurën parlamentare lidhur me këtë projekt, ndërkaq procedimi i mëtejshëm do të thoshte të procedohet gjysma e projektit. **Kryesuesja** ftoi komisionin për votim, ndaj me shumicë votash nxori :

## **REKOMANDIM** (për seancën plenare)

**Projektligji për Tokën Ndërtimore, Privatizimin dhe Dhënien me Qira të Tokës Ndërtimore të kthehet për ripunim propozuesit-Qeverisë së Kosovës.**

### **3. Shqyrtimi i projektligjit për administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi**

**Kryesuesja** ftoi zyrtarët e MMPH të deklarohen para se të filloi shqyrtimi i projektligjit në fjalë.

**Lirije Berisha** tha se në ndërkohë, prej leximit të parë e deri tani, MMPH ka bërë disa ndryshime (propozime) të projektit të cilat i propozon komisionit për miratim. Ajo tha se këto propozime janë kombinuar me ato të njësisë për standardizim të Kuvendit të Kosovës.

**Selvie Halimi** konstatoi se këto propozime u dorëzuan në mbledhjen e sotme, ndaj propozoi grupin punues : **Zef Morina, Elheme Hetemi, Lirije Berisha dhe Bajram Badivuku** të cilët do të takohen të hënën më 9.2.2009 në orën 10,00 (N-225) dhe do ti shqyrtojnë këto propozime, për të propozuar më tutje të martën komisionit vërejtjet konkrete.

Para se ta përfundoi mbledhjen **kryesuesja** kërkoi nga komisioni të deklarohet rreth dy projektligjeve të cilat janë të gatshme për leximin e dytë, pasi që komisioni për komunitete ka përfunduar shqyrtimin e tyre, ndaj komisioni mur :

## **KONKLUDIM**

**Projektligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Projektligji për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis i përcjelljen seancës plenare për leximin e dytë, pasi që ka përfunduar shqyrtimi i tyre në procedurën parlamentare në komisionet e Kuvendit.**

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**